


INSTITUTI EPIK

MAJ 2019

ZGJEDHJET PËR PARLAMENTIN EVROPIAN 2019:
E PANJOHURA E NJOHUR



Më 12 shkurt 2012, Jim Miklaszewski, korrespondent I NBC-së për Pentagonin, nuk kishte idenë se ai do të bëjë pyetjen që do të provokonte ndoshta një nga përgjigjet më të debatueshme të politikës së jashtme moderne amerikane.

Z. Miklaszewski pyti Sekretarin Rumsfeld nëse kishte "ndonjë dëshmi" që lidhin regjimin e Saddam Husseinit në Irak me "organizata terroriste". Sekretari Rumsfeld u përgjigj: "Siç e dimë, ka të njohura të ditura; ka, pra, gjëra që e dimë se i dimë. Gjithashtu e dimë se ka të panjohura të njohura; gjë që i bie se e dimë se ekzistojnë disa gjëra që nuk i dimë. Por gjithashtu ka të panjohura të panjohura — ato që nuk e dimë se nuk i dimë."

Siç do kuptoni në faqet e ardhshme, zgjedhjet e ardhshme të Parlamentit Evropian bien në kategorinë e "panjohurave të njohura".

Në institut kemi debatuar gjatë nëse kjo analogji është analogji më e mirë për zgjedhje të ardhshme të Parlamentit Evropian. Në fund, u dakorduam që është.

Në faqet e ardhshme do të bëjmë përpjekje të shpjegojmë pse

Parashikimi ynë për Parlamentin e ardhshëm Evropian bazohet në sondazhet nacionale të gjeneruara nga POLITICO. 'Trendi i Kalmanit' është përdorur për të krijuar një trend për çdo parti politike kombëtare.

Trendi i Kalmanit është teknikë që ndihmon në eliminimin e boshllëqeve në seritë kohore, duke krijuar trajektore më të sakta, për dallim nga rezultatet e një sondazhi të vetëm – cilat mund të janë të cilësive dhe boshllëqeve të ndryshme.

Projeksionet e këtij studimi bazohen në sondazhet POLITICO-s, të datës 18 maj 2019

Ne kemi verifikuar të dhënat POLITICO-s me katër sondazhe të tjera: sondazhi i Financial Times (maj 2019), EUROPELECTS (maj 2019), Kantar Public, i kontraktuar nga Parlamenti Evropian (prill 2019) dhe parashikimet e ECFR-së (prill 2019). Bazuar në të gjitha këto ne nuk kemi arritur të gjejmë dallime të mëdha në të dhënat e këtyre sondazheve.

Projeksionet e këtij studimi bazohen në sondazhet POLITICO-s, të datës 18 maj 2019

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE



Zgjedhjet e Parlamentit Evropian janë të rëndësishme pasi që Parlamenti Evropian është i vetmi institucion i BE-së i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejt. Parlamenti është i vetmi trup legjislativ në botë, vendimet e të cilit kanë efekt të drejtpërdrejtë ligjor në shumë vende sovraane të BE-së.

Ne vendosëm të kthejmë vëmendjen tonë në zgjedhjet e Parlamentit Evropian kryesisht për dy arsye:

1. Zgjedhjet kanë rëndësi të madhe për vet BE-në. Në kohën kur forcat progresive dhe populiste janë në ballafaqim të drejtpërdrejt në të gjitha kontinente, Parlamenti i ardhshëm Evropian përbënë fushëbetejen e ardhshme strategjike të këtyre forcave kundërshtarë. Zgjedhjet nuk do të përcaktojnë vetëm fatin e BE-së, por balancin e forcave globale.
2. Arsyeja e dytë rrjedh natyrshëm nga ajo e para. Për shkak të rëndësisë së tyre, zgjedhjet do të kenë ndikim të madh në politikat e BE-së karshi Ballkanit Perëndimor dhe Kosovës.

Në përmbledhje, studimi nxjerr shtatë konkluzione:

1. Përkundër humbjes prej afro 6.5%, fronti pro-BE (EPP, S&D, ALDE+En Marche, GREENS-EFA) do të mbesin forca më e madhe politike e BE-së, me 63.2% të votës së përgjithshme.
2. Sidoqoftë, për herë të parë që nga viti 1979, dy të mëdhenjtë, EPP dhe S&D, do të humbasin shumicën. Parashikojmë që ata do të fitojnë 42% të votës së përgjithshme, gjë që do shënon rënie nga 54% në 2014.
3. Pasi që "koalicioni i madh" EPP dhe S&D nuk do të ketë shumicën e Eurodeputetëve në Parlamentin Evropian, kjo familje politike do të duhet të bashkëpunojë me grupet e tjera në Parlamentin e ardhshëm Evropian për të çuar përpara projektin evropian. (ECFR, prill 2019).

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

4. Euroskeptikët (Aleanca Evropiane e Popujve dhe Kombeve (ish-ENF), ECR, GUE / NGL, 5STAR + BREXIT (ish-EFDD)), do të shënojnë rritje prej 2.7%, duke fituar 30.2% të votës së përgjithshme.

5. ALDE+En Marche do të jenë “king-maker” i koalicionit EPP dhe S&D pasi që do të shënojnë rritje të konsiderueshme.

6. Partitë e reja dhe të pa-rreshtuara do të shënojnë rritje prej 3.7%, me 6.5% të votës së përgjithshme.

7. Në mandatin e institucioneve të reja të BE-së, 2019-2024, nuk duhet shpresuar për zgjerim të BE-së drejt Ballkanit Perëndimor. Mund të pritët progres në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë. E njëjta mund të ndodh në rastin e Serbisë, nën supozimin e arritjes së marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën. Në rast të marrëveshjes, Kosova nga ana tjetër do të fitojë liberalizimin e vizave dhe, në një skenar optimist, do të fitojë statusin e kandidatit. Statusin e kandidatit mund të fitojë edhe Bosnja dhe Hercegovina.

FAKTET



Që nga viti 1979, çdo pesë vjet qytetarët e BE-së zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Parlamentin Evropian – institucion i zgjedhur në mënyre të drejtpërdrejt i cili mbron interesat e tyre në kuadër të BE-së.

Asnjë institucion tjetër i BE-së nuk zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasi që Këshilli Evropian dhe Këshilli i BE-së legjitimohen në formë indirekte përmes zgjedhjeve nacionale.

Zgjedhjet e fundit evropiane në 2014 ishin zgjedhjet më të mëdha transnacionale të mbajtura ndonjëherë. Zgjedhjet e ardhshme evropiane do t'iu japin mundësi qytetarëve të BE-së për të zgjedhur 751 deputetë të cilët do t'i përfaqësojnë ata në Parlamentin Evropian. Përcaktimi i numrit të deputetëve është i përcaktuar në kuadër të traktateve të BE-së. Përcaktimi bëhet në bazë të popullsisë, duke iu mundësuar shteteve më të vogla të fitojnë më shumë deputetë se nën sistemin e proporcionalitetit. Aktualisht, numri i Eurodeputetëve varion nga 6 deputetë për Maltën, Luksemburgun dhe Qipron deri më 96 deputetë për Gjermaninë.

Më shumë se 400 milionë qytetarë kanë të drejtë vote, gjë që bënë këto zgjedhje ushtrimin më të madh demokratik në botë, pas Indisë.

Parlamenti Evropian ka tre role kryesore: legjislativ, mbikëqyrës dhe buxhetor. Kjo nënkupton miratimin e ligjeve të BE-së, në bashkëpunim me Këshillin e BE-së, kontrollin demokratik të të gjitha institucioneve të BE-së dhe miratimin e buxhetit të BE-së.

RREGULLAT E LOJËS



Zgjedhjet evropiane organizohen sipas dispozitave të Ligjit Evropian për Zgjedhje (rishikuar në vitin 2002 dhe 2018).

Çdo qytetar i BE-së që jeton në një shtet të BE-së ku ai/ajo nuk është shtetas ka të drejtë të votojë dhe të jetë kandidat në zgjedhjet parlamentare evropiane në vendin e tij të banimit, nën të njëjtat kushte si shtetasit e atij vendi - kjo e drejtë është e përcaktuar në nenin 39 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Përveç kësaj, e drejta për të votuar është e paraparë me nenet 20 (1) dhe 22 (1) të Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian.

Pavarësisht planeve të Britanisë për t'u larguar nga Bashkimi Evropian, Britania e Madhe do të marrë pjesë në zgjedhje për Parlamentin Evropian si një nga kushtet e dakorduara për shtyrjen e BREXIT-it deri më 31 tetor 2019, pasi Britania e Madhe nuk arriti të largohet nga BE-së deri më 29 mars 2019.

Britania e Madhe do të marrë pjesë në zgjedhje për Parlamentin Evropian

RREGULLAT E LOJËS

Detajet praktike të procesit zgjedhor janë të rregulluara me ligjet nacionale dhe zgjedhjet mbahen nën autoritetin e secilit shtet anëtar.

Mosha minimale e votimit është 18 vite, përveç Austrisë dhe Maltës (ku është 16 vjeç) dhe Greqisë (ku është 17 vjeç). Votimi është i detyrueshëm në Belgjikë, Bullgari, Qipro, Greqi dhe Luksemburg.

Disa vende kanë një prag zgjedhor - ku, sipas ligjit, një parti ose një kandidat duhet të fitojë një përqindje të caktuar të votës nacionale për t'u bërë deputet në Parlamentin Evropian. Qëllimi i pragut është që të parandalohet hyrja në Parlament e partive shumë të vogla ose ekstreme, në mungesë të një minimumi të mbështetje së qytetarëve.

Franca, për shembull, është një zonë zgjedhore e vetme me 74 deputet - kështu, pa një prag zgjedhor, do të mjaftonte vetëm 1.4% të votave për të fituar një vend në kuadër të PE-së. Prandaj, Franca ka vendosur pragun zgjedhor në 5%.

Mosha minimale e votimit është 16 vjet në Austri

Një numër i shteteve kanë prag zgjedhor prej minimum 1.8% deri maksimum 5%

RREGULLAT E LOJËS

Vendet ku aplikohet pragu zgjedhor janë:

- 5%: Franca, Lituania, Polonia, Sllovakia, Republika Çeke, Rumania, Kroacia, Letonia dhe Hungaria
- 4%: Austria, Italia dhe Suedia
- 3%: Greqia
- 1.8%: Qipro

Votimi zhvillohet përgjatë tre ditëve, varësisht se ku zhvillohen zgjedhjet:

- 23 maj: Holanda, Britania e Madhe
- 24 maj: Irlanda, Republika Çeke (e cila ka votim dy ditor, edhe më 25 maj)
- 25 maj: Letonia, Malta, Sllovakia
- 26 maj: Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Lituania, Luksemburgu, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovenia, Spanja, Suedia.

Rezultatet përfundimtare do të shpallen të dielën, 26 maj, nga ora 23:00, sipas kohës së Brukselit.

Ekzistojnë tri mënyra të ndryshme për të votuar:


- Personalisht në një vendvotim lokal bazuar në adresën e shtëpisë
- Me postë
- Ose me autorizim (emërimi i dikujt për të votuar në emrin tuaj)

Rezultatet përfundimtare do të shpallen të dielën, 26 maj, nga ora 23:00, sipas kohës së Brukselit


ZGJEDHJET EVROPIANE 2019: RREGULLAT NACIONALE

BURIM: PARLAMENTI EVROPIAN


Election day




Number of MEPs and voting system




Seats after Brexit



Electoral threshold



Voting methods for citizens resident abroad



Minimum age of candidates



PARTITË POLITIKE EVROPIANE



Partitë politike evropiane janë organizatat partiake politike që veprojnë në mënyrë transnacionale në Evropë dhe në institucionet e Bashkimit Evropian. Ato janë të rregulluara dhe financohen nga Bashkimi Evropian dhe përbëhen nga partitë nacionale. Që të njihet si një parti politike evropiane, partia duhet të përbëhet nga deputetë të zgjedhur në së paku një të katërtën e shteteve anëtare.

Që nga nëntori i vitit 2018, këto janë 10 parti politike evropiane të regjistruara:

1. Partia Popullore Evropiane
2. Partia e Socialistëve Evropianë
3. Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve për Evropë
4. Aleanca e Konservatorëve dhe Reformistëve Evropianë
5. Partia e Gjelbër Evropiane
6. Partia e së Majtës Evropiane
7. Lëvizja për Evropën e Kombeve dhe Lirisë
8. Aleanca e Lirë Evropiane
9. Partia Demokratike Evropiane
10. Lëvizja Krishtere Politike Evropiane

**Që nga nëntori i vitit 2018,
janë gjithsej 10 parti politike
evropiane**

PARTITË POLITIKE EVROPIANE

QËNDRIMI POLITIK



Pro-BE



Pro-BE



Pro-BE



Euroskeptikë



Pro-BE

PARTITË POLITIKE EVROPIANE

QËNDRIMI POLITIK



Euroskeptikë



Euroskeptikë



Pro-BE



Pro-BE



Euroskeptikë

GRUPET POLITIKE NË PARLAMENTIN EVROPIAN



Grupet politike bashkojnë Eurodeputetët nga vende të ndryshme anëtare në bazë të lidhjeve të tyre politike, gjë që i jep deputetëve individual ndikim më të madh. Grupet gjithashtu mund të formohen më vonë gjatë mandatit të Parlamentit. Aktualisht në Parlamentin Evropian (2014-2019) ekzistojnë 8 grupe politike:

1. Partia Popullore Evropiane (EPP)
2. Aleanca Progresive e Socialistëve dhe Demokratëve (S&D)
3. Konservatorët dhe Reformistët Evropianë (ECR)
4. Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve për Evropën (ALDE)
5. E Majta e Bashkuar Evropiane – E Majta Veriore e Gjelbër (GUE-NGL)
6. Të Gjelbër/ Aleanca e Lirë Evropiane (Greens-EFA)
7. Evropa e Lirisë dhe Demokracisë së Drejtpërdrejtë (EFDD)
8. Evropa e Kombeve dhe Lirisë (ENF)


Pas zgjedhjeve, deputetët e Parlamentit Evropian formojnë grupe politike

Për të marrë statusin formal të një grupi politik, grupi duhet të përbëhet nga të paktën 25 deputetë, të zgjedhur në të paktën një të katërtën e vendeve anëtare (të paktën 7 vende anëtare). Deputetët mund t'i përkasin vetëm një grupi politik

GRUPET POLITIKE NË LEGJISLATURËN E TETË TË PARLAMENTIT EVROPIAN (2014-2019)

BURIM: PARLAMENTI EVROPIAN

- Left
- Socialists and Democrats
- Green
- Alliance of Liberals and Democrats for Europe
- European People's Party
- European Conservatives and Reformists
- Europe of Freedom and Direct Democracy
- Europe of Nations and Freedom



QENDRA E DJATHTË

PRO-BE



Angela Merkel



Sebastian Kurz



Manfred Weber



Andrej Plenković




Viktor Orbán



Boyko Borissov

QENDRA E MAJTË

PRO-BE



Pedro Sánchez



Jeremy Corbyn



Frans Timmermans



Stefan Löfven



Borut Pahor



Martin Schulz

LA RÉPUBLIQUE
En Marche !

QENDRA

PRO-BE



Emmanuel Macron



Guy Verhofstadt



Charles Michel



Margrethe Vestager



Mark Rutte



Juha Sipilä

E DJATHTA

EUROSKEPTIKË



Matteo Salvini



Marine Le Pen



Norbert Hofer



Geert Wilders



Jörg Meuthen



Tomio Okamura



European
Conservatives
and Reformists
Group



QENDRA E DJATHTË

EUROSKEPTIKË



Theresa May



Jarosław Kaczyński



Jan Zahradil



Jussi Halla-aho

QENDRA E MAJTË

PRO-BE



Ska Keller



Ulrike Lunacek



Oriol Junqueras



Philippe Lamberts



E DJATHTA

EUROSKEPTIKË



Beppe Grillo



Nigel Farage

E MAJTË



Alexis Tsipras

EUROSKEPTIKË



Mary Lou McDonald

SPITZEN KANDIDATEN

Spitzenkandidaten ose procesi i kandidatit kryesor, i përdorur për herë të parë në zgjedhjet evropiane të vitit 2014, u jep qytetarëve të BE-së mundësinë që të ndikojnë drejtpërdrejt në zgjedhjen e kandidatit për President të Komisionit Evropian.

Ajo që filloj si një eksperiment në vitin 2014, ka potencial të ri-fuqizohet me përfitime të mëdha demokratike për BE-në, duke e konfirmuar atë si zgjedhjen e duhur për një BE që nuk ka frikë të diskutojë themelet e saja.

Spitzenkandidaten ishte gjithashtu pasojë logjike e hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, i cili specifikonte se rezultati i zgjedhjeve në Parlamentin Evropian duhet të merret parasysh kur propozohen kandidatët për President të Komisionit Evropian. Traktati i Lisbonës gjithashtu krijoi një lidhje më të ngushtë midis qytetarëve dhe jetës demokratike të BE-së, duke shprehur në mënyrë eksplicite se deputetët e Parlamentit Evropian janë 'përfaqësues të qytetarëve të BE-së. (Qendra për Strategji Politike Evropiane, 16 shkurt 2018)

Spitzenkandidaten ishte pasojë logjike e hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës

SPITZEN KANDIDATEN

Ideja e Spitzenkandidaten u prit me përkrahje nga qytetarët. Në një sondazh të vitit 2014, 63% e të anketuarve u pajtuan me deklaratën se "zgjedhja e Presidentit të Komisionit duke marrë parasysh rezultatet e zgjedhjeve evropiane përfaqësoi përparim të rëndësishëm për demokracinë e BE-së", ndërsa vetëm 18% nuk ishin dakord. (Parlamenti Evropian, 2014, 'Sondazhi Parlamentar 2014: qytetarët gëzohen rolit të Parlamentit në zgjedhjen e Presidentit të Komisionit Evropian').

Bazuar në rezultatet e zgjedhjeve evropiane, një nga Spitzenkandidaten do të zgjidhet President i Komisionit Evropian nga ana e Parlamentit Evropian, pasi të jetë zyrtarisht i propozuar nga krerët e shteteve apo qeverive, të cilët do të marrin parasysh rezultatin e zgjedhjeve evropiane.

Para zgjedhjeve 2019, shtatë parti politike evropiane kanë propozuar gjithsej 15 Spitzenkandidaten apo kandidatë kryesorë. Tre parti politike kanë propozuar më shumë se një kandidat kryesor.

"Nëse doni ta forconi demokracinë evropiane, atëherë nuk mund ta ktheni mbrapa progresin e vogël demokratik që është arritur me propozimin e kandidatëve kryesorë-Spitzenkandidaten. Do të doja që ky proces të vazhdoj". Presidenti i Komisionit Evropian Jean-Claude Juncker, adresimi vjetor para Parlamentit Evropian, më 13 shtator 2017

SPITZEN KANDIDATEN



Manfred Weber



Frans Timmermans

SPITZEN KANDIDATEN



Jan Zahradil



Ekipi Evropë – shtatë
kandidatë kryesorë. Në foto:
Margrethe Vestager

SPITZEN KANDIDATEN




Dy kandidatë kryesorë
Në foto: Ska Keller



Oriol Junqueras

SPITZEN KANDIDATEN




Dy kandidatë kryesorë
Në foto: Nico Cué

PRIORITETET

BURIM: EUROBAROMETER, PRILL 2019

Cilat janë prioritetet kyçe për votuesit?



PROJEKSIONET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019

BURIM: POLITICO, MAJ 2019



Parashikimi ynë për Parlamentin e ardhshëm Evropian bazohet në sondazhet nacionale të gjeneruara nga POLITICO. 'Trendi i Kalmanit' është përdorur për të krijuar një trend për çdo parti politike kombëtare.

Trendi i Kalmanit është teknikë që ndihmon në eliminimin e boshllëqeve në seritë kohore, duke krijuar trajektore më të sakta, për dallim nga rezultatet e një sondazhi të vetëm – cilat mund të janë të cilësive dhe boshllëqeve të ndryshme.

POLITICO përditëson këto të dhëna nacionale me informatat e fundit sa i përket rreshtimeve të partive nacionale me partitë Evropiane, dhe aplikon ndaj rezultati të së secilës parti metodën e kalkulimit – apo ekuivalentin më të përafërt – që vendi respektiv anëtare përdor në zgjedhjet e Parlamentit Evropian (që mund të janë të ndryshme prej metodës që aplikohen në zgjedhjet e tyre nacionale), për të projektuar rezultatin për vitin 2019.

Projeksionet e këtij studimi bazohen në sondazhet POLITICO-s, të datës 18 maj 2019

Ne kemi verifikuar të dhënat POLITICO-s me katër sondazhe të tjera: sondazhi i Financial Times (maj 2019), EUROPELECTS (maj 2019), Kantar Public, i kontraktuar nga Parlamenti Evropian (prill 2019) dhe parashikimet e ECFR-së (prill 2019). Nuk kemi arritur të gjejmë dallime të mëdha në të dhënat e këtyre sondazheve

PROJEKSIONET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019

BURIM: POLITICO, MAJ 2019



Partia Popullore Evropiane (EPP) pritet të humb 46 deputetë, nga 216 (2014) në 170 (2019) deputetë.

Aleanca Progresive e Socialistëve dhe Demokratëve (S&D) pritet të humb 40 deputetë, nga 186 (2014) në 146 (2019) deputetë.

Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve për Evropën (ALDE) + En Marche e Macronit pritet të fitojë 36 deputetë, nga 68 (2014) në 104 (2019) deputetë.

Aleanca Evropiane e Popujve dhe Kombeve (ish-ENF) pritet të fitojë 36 deputetë, nga 36 (2014) në 72 (2019) deputetë.

Konservatorët dhe Reformistët Evropianë (ECR) pritet të humb 16 deputetë, nga 77 (2014) në 61 (2019) deputetë.

Pritet që EPP dhe S&D të humbin deputetë

ALDE/En Marche dhe Aleanca Evropiane e Popujve dhe Kombeve e Salvinit (ish-ENF) pritet të shënojnë rritje konsiderueshme

PROJEKSIONET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019

BURIM: POLITICO, MAJ 2019



Të Gjelbër/Aleanca e Lirë Evropiane (Greens-EFA) pritet të fitojë 3 deputetë, nga 52 (2014) në 55 (2019) deputetë.

E Majta e Bashkuar Evropiane – E Majta Veriore e Gjelbër (GUE-NGL) pritet të humb 3 deputetë, nga 52 (2014) në 49 (2019) deputetë.

Partitë e reja dhe të pa rreshtuara pritet të fitojnë 28 deputetë, nga 21 (2014) në 49 (2019) deputetë.

5Star+Partia Brexit (ish-EFDD) pritet të fitojë 3 deputetë, nga 42 (2014) në 45 (2019) deputetë.

Përderisa, GREENS/EFA dhe 5Star/BREXIT do rritin numrin e deputetëve, GUE/ENL do shënojë rënie

Partitë e reja dhe të pa rreshtuara do të kanë rritje të konsiderueshme

PROJEKSIONET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019

BURIM: POLITICO, MAJ 2019



Bazuar në këto të dhëna mund të nxjerrim shtatë konkluzione kyçe:

1. Përkundër humbjes prej afro 6.5%, fronti pro-BE (EPP, S&D, ALDE+En Marche, GREENS-EFA) do të mbesin forca më e madhe politike e BE-së, me 63.2% të votës së përgjithshme.
2. Sidoqoftë, për herë të parë që nga viti 1979, dy të mëdhenjtë, EPP dhe S&D, do të humbasin shumicën. Parashikojmë që ata do të fitojnë 42% të votës së përgjithshme, gjë që do shënon rënie nga 54% në 2014.
3. Pasi që "koalicioni i madh" EPP dhe S&D nuk do të ketë shumicën e Eurodeputetëve në Parlamentin Evropian, këto familje politike do të duhet të punojnë me grupet e tjera në Parlamentin e ardhshëm Evropian për të çuar përpara projektin evropian. (ECFR, prill 2019).
4. Euroskeptikët (Aleanca Evropiane e Popujve dhe Kombeve (ish-ENF), ECR, GUE / NGL, 5STAR + BREXIT (ish-EFDD)), do të shënojnë rritje prej 2.7%, duke fituar 30.2% të votës së përgjithshme.


5. Pasi që do të shënojnë rritje të madhe, ALDE+En Marche do të jenë "king-maker" i koalicionit EPP dhe S&D.

6. Partitë e reja dhe të parrështuara do të shënojnë rritje prej 3.7%, me 6.5% të votës së përgjithshme.

7. Në mandatin e institucioneve të reja të BE-së, 2019-2024, nuk duhet shpresuar për zgjerim të BE-së drejt Ballkanit Perëndimor. Mund të pritët progres në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë. E njëjta mund të ndodhë në rastin e Serbisë, nën supozimin e arritjes së marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën. Në rast të marrëveshjes, Kosova nga ana tjetër do të fitojë liberalizimin e vizave dhe, në një skenar optimist, do të fitojë statusin e kandidatit. Statusin e kandidatit mund të fitojë edhe Bosnja dhe Hercegovina.










PROJEKSTIONET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019

BURIM: POLITICO, MAJ 2019



Seats by group and change compared to present

UK PARTICIPATES


 European People's Party (EPP)	170	↓ 46	 Progressive Alliance of Socialists and Democrats (S&D)	146	↓ 40
 Alliance of Liberals and Democrats for Europe (ALDE) + En Marche	104	↑ 36	 Salvini's European Alliance of People and Nations (ex-ENF)	72	↑ 36
 European Conservatives and Reformists (ECR)	61	↓ 16	 The Greens/European Free Alliance (Greens-EFA)	55	↑ 3
 European United Left/Nordic Green Left (GUE/NGL)	49	↓ 3	 New and unaffiliated parties	49	↑ 28
 5Star's group + Brexit Party (ex-EFDD)	45	↑ 3			

PROJEKSIONET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019



2014



2019



- EPP
- ECR
- GREENS/EFA
- 5Star's group+Brexite Party (ex-EFDD)
- New + unaffiliated parties
- S&D
- ALDE+En Marche
- GUE/NGL
- ENF

FITUESIT

BURIM: POLITICO, MAJ 2019



LA RÉPUBLIQUE
En Marche !

36
deputetë ↑



36
deputetë ↑

PARTITË E REJA DHE
TË PA RRESHTUARA

28
deputetë ↑

HUMBËSIT

BURIM: POLITICO, MAJ 2019



46
deputetë



40
deputetë



KOALICIONI I ARDHSHËM?

BURIM: POLITICO, MAJ 2019



ALLIANCE OF LIBERALS AND
DEMOCRATS FOR EUROPE >>

420

nga

751

deputetë

LA RÉPUBLIQUE
En Marche !

PROJEKSIONET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019

BURIM: POLITICO, MAJ 2019

NUMRI I VENDEVE NË TË CILIN GRUPI ËSHTË PROJEKTUAR TË FITOJË



14

AUSTRIA, KROACIA, QIPROJA, GJERMANIA, GREQIA, FINLANDA, HUNGARIA, LITUANIA, LUKSEMBURGU, IRLANDA, PORTUGALIA, RUMANIA, SLLOVENIA, SUEDIA



LA RÉPUBLIQUE
En Marche !

4

ESTONIA, DANIMARKA, HOLANDA, FRANCA



European
Conservatives
and Reformists
Group

3

BELGJIKË, POLONI, SLLOVAKI



3

BULLGARI, SPANJË

PARTITË E REJA DHE TË PA RRESHTUARA

2

REPUBLIKA ÇEKE, LETONI



1

MBRETËRIA E BASHKUAR



1

ITALI

PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 751

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019




PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019

BURIM: POLITICO, MAJ 2019


DEPUTETË: 18

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019



PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 21

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019



PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 17

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019



PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 6

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019



PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 21

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019



PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 96

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014




2019



PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 13

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019




PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019

BURIM: POLITICO, MAJ 2019


DEPUTETË: 6

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019



PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 54

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019



PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 13

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014




2019



PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 74

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019



PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 21

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019



PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 11

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019



PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 21

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014




2019



PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 11

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019




PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019

BURIM: POLITICO, MAJ 2019


DEPUTETË: 73

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019



PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 11

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019




PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019

BURIM: POLITICO, MAJ 2019


DEPUTETË: 6

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019




PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019

BURIM: POLITICO, MAJ 2019


DEPUTETË: 8

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014




2019



PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 6

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019




PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019

BURIM: POLITICO, MAJ 2019


DEPUTETË: 26

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019




PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019

BURIM: POLITICO, MAJ 2019


DEPUTETË: 51

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019



PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 21

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019



PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 32

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019



PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 20

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019




PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019

BURIM: POLITICO, MAJ 2019




PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019



PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 13

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019



PROJEKTIMET E ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019


BURIM: POLITICO, MAJ 2019




DEPUTETË: 73

PRO-BE VS EUROSKEPTIKË

2014



2019



SHTETET KU MUND TË KËTË BEFASIRA?

Pak ditë para zgjedhjeve, ende ka shumë elemente në skenën e politikës evropiane cilat mund të shtyjnë rezultatin e zgjedhjeve në drejtime të ndryshme. Në shumë shtete të mëdha anëtare, sikur Spanja - e cila mbajti zgjedhjet nacionale parlamentare në fund të prillit - zhvillimet politike të brendshme mbizotëronin në media dhe diskurs publik, dhe qytetarët duket se nuk e kanë kthyer ende mendjet e tyre në zgjedhjet Evropiane. Rezultati i zgjedhjeve nacionale do të ketë ndikim në mënyrën se si ata do votojnë në zgjedhjet e Parlamentit Evropian.

Në Bruksel dhe Strasburg, dy selitë e Parlamentit Evropian, ka zhvillime të vazhdueshme brenda familjeve politike pan-evropiane. Anëtarë të bllokut të qendrës - Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve për Evropën (ALDE) dhe La République En Marche! - kanë filluar të bien dakord se si do të punojnë së bashku. Këto do të jenë zgjedhjet e para evropiane për La République en Marche (LREM) të Presidentit Emmanuel Macron. Nga ana tjetër, brenda Partisë Popullore Evropiane (EPP) ende ka tensione të larta për shkak të pezullimit për kohë të pacaktuar të partisë FIDESZ të Kryeministrit Hungarez Orban.

Përveç pasigurisë së BREXIT-it në Britani të Madhe, ankthi pan-Evropian rreth migrimit mund të ndikon në rezultatin e zgjedhjeve në favor të partive nacionaliste dhe populliste.

Një nga këto vende është Italia ku qeveria përbëhet nga koalicioni nationalist-popullist mes Liges së Sallvinit dhe Lëvizjes Five Star - të dy parti me qëndrime ekstreme kundër migrimit.

Liga e Salvinit ka ndërtuar një aleancë zgjedhore me Frontit Nacional të Le Penit, Partinë e Lirisë së Wildersit, Alternativën e ekstremit të djathtë për Gjermaninë (AfD), Partinë Finlandeze dhe Partinë Popullore Daneze.

Në Austri, pak ditë përpara zgjedhjeve, qeveria u rrëzua, pasi që udhëheqësi i Partisë së djathtë për Liri është përfshirë në një skandal korrupsioni. Efektet e këtij zhvillimi do të ndikojnë në disponimin e votuesve austriak në zgjedhjet evropiane.

ÇFARË DO TË NDODH PAS ZGJEDHJEVE?

Duke marrë parasysh rezultatin e zgjedhjeve, deputetë të ri të Parlamentit Evropian do të themelojnë grupet politike. Përbërja politike e parlamentit të ri mund të kërkojë krijimin e aleancave dhe grupeve të reja. Në sesionin e parë plenar, parlamenti i ri do të zgjedhë Presidentin e Parlamentit Evropian.

Pastaj, deputetët do të zgjedhin Presidentin e ardhshëm të Komisionit Evropian dhe do të miratojnë përbërjen e plotë të Komisionit të ri Evropian.

Partitë politike evropiane kanë zgjedhur kandidatët kryesorë për Presidencën e Komisionit Evropian. Pas zgjedhjeve dhe duke marrë parasysh rezultatet, krerët e BE do të propozojnë një kandidat për President të Komisionit Evropian. Parlamenti ka bërë të qartë se nuk do të pranojë një kandidat i cili nuk ka marrë pjesë në procesin spitzenkandidaten. Në muajin korrik, Parlamenti do të votojë për Presidentin e ri të Komisionit Evropian.

**Në sesionin e parë plenar,
parlamenti i ri do të zgjedhë
Presidentin e Parlamentit
Evropian**

ÇFARË DO TË NDODH PAS ZGJEDHJEVE?



Më pas, vendet e BE-së, në bashkëpunim me Presidentin e ri të Komisionit Evropian, do të propozojnë Komisionerë për të udhëhequr dikastere të ndryshme të Komisionit Evropian. Komisionerët e propozuar do të intervistohen nga komisionet parlamentare përgjegjëse për dikasteret e tyre përpara se deputetët të votojnë përbërjen e plotë të Komisionit Evropian në seancë plenare.

Komisioni në përbërje të plotë, duke përfshirë Presidentin e Komisionit Evropian dhe Përfaqësuesin e Lartë për Punë të Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, në fund duhet të miratohet me shumicën e votave në Parlamentin Evropian.

Pasi Presidenti dhe Komisionerët janë miratuar nga Parlamenti, ata formalisht do të emërohen me shumicë të kualifikuar nga Këshilli Evropian.

Komisioni i ri Evropian do të inaugurohet deri me 1 Nëntor 2019

Komisioni i ri Evropian do të inaugurohet deri me 1 Nëntor 2019

ÇFARË DO TË NDODH PAS ZGJEDHJEVE?



CONSOLIDATED VERSION OF THE TREATY ON THE EUROPEAN UNION, ART. 17.7 / DECLARATION 11 ANNEXED TO THE TREATY. BASED ON THE TIMELINE OF THE 8TH TERMVERSIONI I KONSOLIDUAR I TRAKTATIT PËR BASHKIMIN EVROPIAN, NENI 17.7 / DEKLARATA 11, SHTOJÇË E TRAKTATIT. BAZUAR NË AFATET KOHORE NË LEGJISLATURËN E TETË..

23-26
Maj

Zgjedhjet Evropiane

20-21
Qershor

Duke marrë parasysh rezultatin e zgjedhjeve, Këshilli Evropian, me shumicë të kualifikuar, propozon Presidentin e Komisionit Evropian

2
Korrik

Seanca plenare dhe inauguruese e Parlamentit Evropian dhe zgjedhja e Presidentit të Parlamentit

Korrik

Zgjedhja e Presidentit të Komisionit nga Parlamenti Evropian, me shumicën e votave (të paktën 376)

Gusht/
Shtator

Shtetet Anëtare propozojnë Komisionerë të tyre, në konsultim me Presidentin e Komisionit

Shtator/
Tetor

Intervistat e Komisionerëve në komisionet parlamentare të Parlamentit Evropian

Tetor/
Nëntor

Votimi i përbërjes së plotë të Komisionit Evropian nga ana e Parlamentit, me shumicën e votave. Këshilli Evropian, me shumicë të kualifikuar, emëron Komisionin e ri Evropian

Nëntor

Inagurimi i Komisionit të ri Evropian

NDIKIMI NË BALLKANIN PERËNDIMOR



Në korrik 2014, Presidenti i Komisionit Evropian, z. Jean-Claude Juncker, prezantoi Udhëzimet e tij Politike për Komisionin e ardhshëm Evropian. Në kuadër të dokumenti, u nënvizua: "... nën Presidencën time, negociatat e anëtarësimit do të vazhdojnë dhe Ballkani Perëndimor do të duhet të ruaj perspektiven Evropiane, por në pesë vite të ardhshme nuk do të ndodh asnjë zgjerim i mëtejshëm i BE-së".

Kjo fjali e vetme ka përmbledhur në mënyrë të përkryer qëndrimin e Shteteve Anëtare për agjendën e zgjerimit. Qëndrimi i Presidentit Juncker gjeneroj një sasi të konsiderueshme kritikash në atë kohë, megjithatë sot mund të cilësojmë qëndrimin e tij si realist.

Parlamenti Evropian në largim ishte mbështetës i fuqishëm i agjendës së zgjerimit. Megjithatë, në pesë vitet e fundit Shtetet Anëtare ishin të preokupuara me çështje të brendshme nacionale, duke filluar nga kriza e migrimit, rritja e nacionalizmit në gjithë Evropën, erozioni i demokracive në Hungari dhe Poloni, BREXIT etj.

Një mjedis i tillë politik ka bllokuar çfarëdo përparimi të rëndësishëm të Ballkanit Perëndimor drejt BE-së, gjatë mandatit të fundit institucional të BE-së.

Zgjedhjet e ardhshme evropiane do të janë reprizë e pesë viteve të fundit.

Rezultati i zgjedhjeve, me koalicione më të vogla tradicionale dhe një Parlament shumë më të fragmentuar, do të ndikojë në axhendën legjislativ të BE në vitet e ardhshme. Kjo është për shkak se legjislacioni i BE-së në pothuajse të gjitha fushat e politik-bërjes kërkon mbështetjen e shumicës së deputetëve. Koalicionet legjislativ në Parlament tradicionalisht formësohen "çështje për çështje", me koalicione të ndryshme që dominojnë në fusha të ndryshme të politikave. Në parlamentin 2014-19, koalicioni qendror, mes EPP, ALDE dhe Konservatorëve dhe Reformistëve Evropian (ECR), ka miratuar legjislacionin në fushën e rregullimit të

NDIKIMI NË BALLKANIN PERËNDIMOR



tregut unik (siç është rregullimi i shërbimeve financiare), reformën e Eurozonës dhe marrëveshjet që kanë promovuar tregtinë ndërkombëtare.

Nga ana tjetër, koalicioni i qendrës së majtë - midis socialistëve, ALDE, të gjelbërve dhe të majtës (EUL / NGL) - ka miratuar legjislacionin në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme (psh. lëvizja e lirë e njerëzve dhe politikave të refugjatëve), çështjet mjedisore dhe çështjet të ndihmës zhvillimore ndërkombëtare.

Me parlamentin e ri shumë më të fragmentuar, secili prej këtyre koalicioneve do të jetë më i vogël dhe do të jetë më vështirë që të formësohet shumica e nevojshme. Në këtë kontekst, deputetët populist të BE-së, veçanërisht të djathtët, do të janë në pozitë të favorshme që të formësojnë politik-bërjen.

Po ashtu, Eurodeputetët populistë me gjasë do fitojnë pozita kyçe brenda Parlamentit Evropian, siç janë pozitat e kryesimit të komisioneve të ndryshme dhe pozitat e raportuesve.

Me këtë fuqi të re, mund të presim që këta deputetë do të influencojnë politikave më të ashpëra ndaj refugjatëve dhe azilkërkuesve, rritjen e shpenzimeve për mbrojtjen e kufijve të BE-së, rritjen e fuqisë së shteteve anëtare për të rritur deficitin në Eurozonë, dhe promovimin e politikave proteksioniste tregtare.

Kryetituj të mediave Evropiane pas zgjedhjeve me gjasë do të përqendrohen në rritjen e euroskeptikëve populistë anëtarë Evropës, në kurriz të pro-evropianëve. Dhe kjo rritje do të jetë me ndikim. Parlamenti i ri do të jetë një partner i pa përshtatshëm për qeveritë nacionale dhe Komisionin Evropian, i cili nuk do të jetë në gjendje të mbështetet në një koalicion të qëndrueshëm. Në këtë drejtim, në vitet e ardhshme mund të jemi dëshmitar të bllokimit institucional të BE-së, gjë që do mund të nxit më tej ndjenjat anti-evropiane në shumë vende anëtare. (Zgjedhjet Evropiane dhe BREXIT, maj 2019).

NDIKIMI NË BALLKANIN PERËNDIMOR



Në një sfond të tillë, duhet të jemi skeptik rreth perspektives së zgjerimit të Ballkanit Perëndimor në pesë vitet e ardhshme. Udhëzimet politike të korrikut 2014 do të kenë nevojë vetëm për ndryshimin e datës - përndryshe ato do të jenë të vlefshme për 2019-2024.

Në mandatin e institucioneve të reja të BE-së, 2019-2024, nuk duhet shpresuar për zgjerim të BE-së drejt Ballkanit Perëndimor. Mund të pritët progres në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë. E njëjta mund të ndodh në rastin e Serbisë, nën supozimin e arritjes së marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën. Në rast të marrëveshjes, Kosova nga ana tjetër do të fitojë liberalizimin e vizave dhe, në një skenar optimist, do të fitojë statusin e kandidatit. Statusin e kandidatit mund të fitojë edhe Bosnja dhe Hercegovina.

INSTITUTI I KOSOVËS PËR POLITIKAT EVROPIANE, 2019.
TE GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA.

